**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | |
|---|---|---|
| ***Eksperti shqyrtues i prokurimit:***<br><br>***Valon Jahaj: _____*** | ***Data e autorizimit të ekspertit:***<br>**10/05/2022** | ***Data e dorëzimit të raportit:***<br>**20/05/2022** |

## 1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.05.2022, **OE "ASSECO SEE" SH.P.K. - Prishtinë**, dhe me datë 06.05.2022, **OE "PBC" SH.P.K. – Prishtinë**, kanë parashtruar ankesat me nr. **124/22,** respektivisht **129/22**, kundër njoftimeve mbi vendimet e refuzimit të kërkesave për rishqyrtim dhe njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër **"214-22-1548-2-2-1"** dhe me titull **" Mirëmbajtja e sistemit te menaxhimit te informatave ne laborator (LIMS) ne AKF"** inicuar nga **(AK)** – **Ministria e Punëve të Brendshme - MPB.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, vlerë të **mesme**, lloji i kontratës: **shërbime,** vlera e parashikuar e kontratës: **63,720.00 €.**

Datat për fazat e ndryshme të Aktivitetit të Prokurimit deri tek ankesat në OSHP janë si në vijim:

Data e publikimit të njoftimit për kontratë: 07.03.2022
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 29.03.2022
Përgjigje në kërkesën për informacione shtesë: 18.03.2022
Vendimi i AK-së: 21.04.2022
Kërkesa për rishqyrtim 1: 23.04.2022
Kërkesa për rishqyrtim 2: 26.04.2022
Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim 1: 29.04.2022
Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim 2: 29.04.2022
Ankesat 124/22 në OSHP: 05.05.2022
Ankesat 129/22 në OSHP: 06.05.2022.

Konform nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, eksperti shqyrtues i prokurimit i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE

***Pretendimet Ankimore të ankesës me numër 124/22, OE Ankues: "ASSECO SE SH.P.K." - Prishtinë:***

***Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:***

*Neni 72*

*Neni 6*

*Dhe Neni 59 paragrafi 2 i LPP-së*

***Deklaratë e detajuar mbi faktet dhe argumentet***

**Neni 72 dhe 59.2 lidhur me nenin 6 te LPP-se:**

Ne baze te letres standarde per tenderuesin e eliminuar, perkatesisht ne arsyetimin e saj, shihet qarte se te dy arsyet per eliminim te OE ankues kane te bejne me mungese sqarimesh te cilat kane pasur mundesi te plotesohen sikur AK te kerkokne nga OE ankues.

Mungesa e autorizimit te zyrtarit pergjegjes per nenshkrim te ofertave/tendereve te OE ankues dhe mungesa e kontratave te punes per vitet paraprake per punonjesit e kerkuar ka mundur shume lehte te sqarohet nese AK do te shfrytezonte te drejten dhe mundesite ligjore nga neni 59.2 dhe neni 72 i Ligjit per Prokurim Publik per te kerkuar informata dhe sqarime shtese nga OE ankues. Aq me teper nese kesaj i shtohet detyrimi i AK nga neni 6 i LPP-se qe te sigurohet qe fondet publike te perdoren ne menyren me ekonomike ne menyre qe te shmanget oferta me çmim me te larte, siç ka ndodhur ne rastin konkret.

Per dijeni te AK dhe komisionit vleresues, OE ankues eshte kompani me kapital nderkombetar me standarde dhe procese te punes te certifikura nderkombetarisht, prandaj ne asnje menyre nuk mund te ndodh qe nje punonjes i saj te nenshkruaj per dhe ne emer te saj pa qene person i autorizuar, qofte permes ligjit/statutit apo permes autorizimit/prokures se posaçme. Ne rastin konkret, natyrisht qe personi qe ka nenshkruar per dhe ne emer te ASSECO SEE ka autorizim te posaçem per perfaqesim te ASSECO SEE ne procedura te prokurimit, meqe pozita e saj nderlidhet kryesisht me pergatitje te ofertave per pjesemarrje ne aktivitete te prokurimit. Mirepo, duke marre per baze praktiken e deritanishme, qe asnjehere nuk eshte kerkuar autorizimi si deshmi e bashkangjitur ne oferten e tenderuesit, edhe ne kete rast OE ankues nuk e ka bashkangjitur. Prandaj e gjithe kjo "paqartesi" ka mund te eliminohet fare lehte nese AK do te kerkonte sqarime shtese sipas mundesive ligjore nga neni 59.2 dhe 72 i LPP-se.

Ngjashem eshte situata edhe me deshmite e pervojes se punes per stafin e angazhuar ne kete projekt. Ne oferten e dorezuar nga OE ankues eshte bashkangjitur kontrata e vitit aktual, meqe kontrata jane 1 vjeçare dhe çdo vit hartohen kontrata te reja per shkak te ndonje ndryshimi eventual, si dhe CV-te e tyre ne te cilen shihet qarte se te njejtit jane te angazhuar ne ASSECO SEE me shume 3 (tre) vite. Nese AK do te kishte per qellim qe te sqaronte dilemat per te cilat e ka eliminuar OE ankues atehere edhe ne kete rast do te duhej te shfrytezohej mundesia e kerkeses per informata shtese qe jep Ligji per Prokurim Publik.

Per fund, duke qene se aryset e eliminimit te OE ankues jane krejtesisht per shkak te mungeses se sqarimeve ne mes te AK dhe OE ankues dhe nuk ndikojne ne permbajtje te ofertes, dhe duke marre per baze dallimin ne oferten financiare te OE fitues dhe OE ankues, konsiderojme se AK e ka mundesine qe te shfrytezoj te drejen ligjore per te kerku informata dhe sqarime te nevojshme nga OE ankues ne menyre qe te mos t'ia humb te drjeten OE ankues per te fituar kete kontrate dhe njekohesisht qe te perdore fondet publike ne menyren me ekonomike duke kursyer buxhetin publik per afer 10,000.00 EUR. Prandaj, AK pas shqyrtimit te kerkeses per rivleresim duhet miratoj kerkesen si te bazuar, te anuloj ne teresi vendimin per dhenie te kontrates dhe te beje rivleresimin e tendereve.

***Pretendimet Ankimore të ankesës me numër 129/22, OE Ankues: "PBC SH.P.K." – Prishtinë***

***Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:***

Konsiderojmë se Autoritet Kontraktues, me ose pa vetëdije, kërcënoni te shkelni:

- Paragrafin 2 të nenit 7 të Ligjit për Prokurim Publik
- Paragrafin 4 te nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik
- Rregullat dhe Udhezuesi operativ për Prokurim Publik

***Deklaratë e detajuar mbi faktet dhe argumentet***

Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 2 te nenit 7, paragrafin 4 te nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik, sepse:

1. Nuk ka trajtuar ne mënyrë te barabarte Operatoret Ekonomik (OE) dhe ka vepruar në mënyrë jo transparente duke mos eliminuar Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontrate i cili ka përpiluar ofertë në që NUK i përmbush kërkesat minimale të njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit.

2. Operatori i rekomanduar për kontrate, nuk përmbushë kërkesat minimale në njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit, për faktin se:

A. NUK e ka dorëzuar listën e kontratave sipas kërkesës në njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit.

Provë:

a. Kërkesa e Autoriteti Kontraktues:

| | |
|---|---|
| c. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku (1) një kontrat për shërbime në lëmin e zhvillimit të softuerëve ose mirëmbajtjes së sistemeve (softuerëve) të realizuar në tri vitet e shkuara para datës së publikimit te këtij njoftimit për kontratë. | c. Listën e kontratave **që specifikon shërbimet e përfshira**; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin, duke ia bashkëngjitur dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë, (kopje). |

b. Lista e kontratave e dorëzuar nga Operatori Ekonomik:

LEAD tech

**LISTA E KONTRATAVE TË REALIZUARA**

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | E-maili i Blerësit | Numri i telefonit te Blerësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mirëmbajtja e sistemit IBIS me numër identifikues 214/18/008/125<br><br>Kontratë 36 muaj | 01.07.2018 | 01.07.2021 | **382,500.00 €** | Ministria e Punëve të Brendshme | Besim SHALA<br><br>Menaxher i Kontratës<br><br>besim.i.shala@rks-gov.net | 044- 201-765 |

*LEADTECH SH.P.K.*

Pra nga prova më larte, shihet qartë se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, NUK ka dorëzuar listën e kontratave që **specifikon shërbimet e përfshira** siç ka qene kërkesë e Autoritet Kontraktues në njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit.

B. NUK e ka dorëzuar oferte teknike sipas kërkesës në njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit, por ka nënshkruar dhe vulosur kërkesën e Autoritet Kontaktues, Aneks 1.

Provë:
a. Aneks 1 – Specifikimet Teknike te Detyrueshme.
b. Kërkesa e Autoriteti Kontraktues - Aneks 1 - Specifikimet Teknike te Detyrueshme, i nënshkruar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate.

Pra nga prova e specifikuara më larte, shihet qartë se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, NUK ka dorëzuar oferte teknike, NUK ka konfirmuar ose deklaruar se i përmbushë kërkesat e Autoritet Kontraktues të cilat kanë qenë të DETYRUSHME.

Pas qasjes në dokumente, kemi vrenjtur se Operatorit Ekonomik i rekomanduar për kontratë për përvojën e punës për stafit e propozuar për këtë projekte, ka dorëzuara letër referenca kinse të njëjtit janë të angazhuar në LEDTECH nga viti 2018. Pas analizimit të letër referencave të lëshuara nga Operatori Ekonomik, CV dhe pasqyrës së trustit, pjesë e ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontrate, kemi vrenjtur se ka shpërputhje në mes të asaj që u thënë në letër referenca, CV dhe pasqyrës së trustit. Në letër referenca të lëshuara nga LEDTECH thuhet se stafi i propozuar në ketë projekte, janë të angazhuar në kompaninë tonë që nga viti 2018 dhe vazhdojnë ende, ndërsa në CV të dy eksperteve të rekomanduar për zhvillim softueri, NUK shkruan që kamë qenë ose janë të angazhuar në kompaninë LEDTECH. Po ashtu në pasqyrën e trustit për ekspertin e rekomanduar për zhvillim dhe mirëmbajtjeje të bazave të të dhënave, NUK figuron se i njëjti ka pranuar ndonjëherë pagese nga kompania LEDTECH. Siç duket nga ngjarja, veç është konsumuar vepra penale, sepse janë dorëzuar dokumente të rrejshme.

Provë:
a. Letër referencat e lëshuara nga Operatori Ekonomike për stafin e propozuar,
b. CV pjese e ofertës së dorëzuar për dy ekspertet e propozuar për zhvillim te softuerit,
c. Pasqyra e trustit për ekspertin e propozuar për zhvillim dhe mirëmbajtjeje të bazave të të dhënave.

Pra nga prova e specifikuara më larte, shihet qartë se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, me ose pa vetëdije ka qitur në lajthitje Autoritetin Kontraktues duke dorëzuar dokumente të rrejshme dhe rrjedhimisht stafi i rekomanduar për kontrate, nuk i përmbushe kërkesat për përvojën e punës siç ka qenë kërkesë në njoftimin për kontrate dhe dosjes së tenderit. Të tre (3) ekspertet e rekomanduar, sipas CV dhe pasqyrës së trustit, pjesë e ofertës së dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, janë të angazhuar në kompani/institucione tjera dhe në pozita të punës që nuk përkojnë me kërkesën e Autoriteti Kontraktues për përvojën e kërkuar. Përveç CV edhe pasqyrës së trustit, certifikimet e dorëzuara për stafin e propozuar për këto pozita, pjese e ofertës së dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, dëshmojnë qartë së të njëjtit nuk e përmbushin përvojën e punës sipas kërkesës në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit.

C. Pas qasjes në dokumente, kemi vrenjtur se Operatorit Ekonomik i rekomanduar për kontratë NUK ka dorëzuar sigurimin e ofertës në përputhje me kërkesën e Autoriteti Kontraktues. Kërkesa e Autoriteti kontraktues në njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit ka qenë që sigurimi i ofertës të jetë vlaid për 90 ditë ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar sigurimin e ofertës me validitet 89 dite.

Provë:

a. Kërkesa e Autoritet Kontraktues për sigurim te ofertës,
b. Sigurimi i ofertës i dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate.

Pra nga prova e specifikuara më larte, shihet qartë se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, NUK ka dorëzuar sigurimin e ofertës në përputhje me njoftimin për kontrate dhe dose te tenderit.

Nga ajo që shihet dhe fuqishëm është theksuar më sipër, shihet qartë se komisioni i vlerësimit, me ose pa vetëdije gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar LPP. Për këtë arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që lënda të kthehet në rivlerësim, në të kundërtën pa dëshirën tonë, jemi të obliguar të dorëzojmë ankese në Organi Shqyrtues i Prokurimit.

## 3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

***N/A***

## 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Raporti i komisionit vlerësues është përgaditur me datën 08.04.2022.

Sipas procesverbalit të hapjes së tenderëve që mbanë datën 29.03.2022, për ketë aktivitet të prokurimit publik janë pranuar tri (3) oferta nga OE, si në tabelën në vijim:

| Nr. | Tenderuesi | Vlera me TVSH euro |
|---|---|---|
| **1.** | "PBC SH.P.K." - Prishtinë | 63,540.00 |
| **2.** | "ASSECO SEE SH.P.K." - Prishtinë | 43,966.80 |
| **2.** | "LEADTECH SH.P.K." - Prishtinë | 52,200.00 |

Anëtarët e komisionit vlerësues të tenderit janë:

1. Shpresa Gashi Fejza
2. Arsim Xhemajli
3. Agron Hoti

Komisioni i vlerësimit të tenderit, nga tri ofertat e dorëzuara, ofertën e **OE "ASSECO SEE SH.P.K."** e ka refuzuar si të teknikisht dhe administrativisht të papërgjegjshme dhe ka propozuar që oferta e **OE "LEADTECH SH.P.K"** të shpërblehët me kontratë, si ofertë e përgjegjshme me çmimin me të ulët, nga të dy ofertat e mbetura, e që janë konsideruar si të përgjegjshme nga komisioni vlerësues i tenderit.

Sipas raportit të vlerësimit dhe Njoftimit mbi vendimin e AK-së, arsyet eleminimit të ofertave të Operatorëve Ekonomik ankues janë si në vijim:

Arsyetimi për refuzimin e ofertës se OE ASSECO SEE SH.P.K. sipas njoftimit mbi vendimin e

AK-se dhe komisionit vlerësues të ofertave janë:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E PRANUSHMËRISË

| Dokumenti | PBC SH.P.K. | ASSECO SEE SH.P.K. | " LEADTECH " SH.P.K. |
|---|---|---|---|
| | Në pajtim / Nuk është në pajtim | Në pajtim / Nuk është në pajtim | Në pajtim / Nuk është në pajtim |
| a.Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. | Në pajtim | I papajtueshëm | Në pajtim |
| b.Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. | Në pajtim | Në pajtim | Në pajtim |
| c.Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. | Në pajtim | Në pajtim | Në pajtim |

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë e pranushmërisë:

**Komisioni i vlerësimit gjatë ekzaminimit, vlerësimit te ofertave ka vërejtur se dokumentet e ofertës(deklarata nen betim, përshkrimi i çmimit) nuk janë nënshkruar nga pronari apo personat e autorizuar te cilët figurojnë ne ARBK , dokumentet janë te nënshkruara nga një person i cili nuk ka prezantuar autorizim me oferte .**

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

| Dokumenti | PBC SH.P.K. Në pajtim / Nuk është në pajtim | ASSECO SEE SH.P.K. Në pajtim / Nuk është në pajtim | " LEADTECH " SH.P.K. Në pajtim / Nuk është në pajtim |
|---|---|---|---|
| Operatori ekonomik pjesmarres duhet te kete | Në pajtim | I papajtueshëm | Në pajtim |
| a.Minimum dy (2) Ekspert për zhvillim të softuerit më përvojë mbi 3 vjeçare në zhvillim të softuerit | Në pajtim | I papajtueshëm | Në pajtim |
| b.Minimum një (1) Ekspert të bazave të te dhënave më përvojë mbi 3 vjeçare në administrim dhe zhvillim të bazave të te dhënave,; | Në pajtim | I papajtueshëm | Në pajtim |
| c.Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku (1) një kontrat për shërbime në lëmin e zhvillimit të softuerëve ose mirëmbajtjes së sistemeve (softuerëve) të realizuar në tri vitet e shkuara para datës së publikimit te këtij njoftimit për kontratë. | Në pajtim | Në pajtim | Në pajtim |

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

**OE për ketë kërkesë ka prezantuar listën e punëtoreve dhe dëshmitë tjera kopjen e diplomave universitare për fushën e TI. Mungon përvoja për stafin e kërkuar me dosje te tenderit , nuk ka dorëzuar reference nga punëdhënësi/it për përvojën 3 vjeçare stafin e kërkuar.**

Arsyetimi për refuzimin e ofertës se **OE PBC SH.P.K.** sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe komisionit vlerësues të ofertave është që oferta e tyre nuk ka qenë oferta e përgjegjshme me çmimin me të ultë.

Vlerësimi i komisionit është aprovuar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të AK-së me datë 14.04.2022 dhe me datën 21.04.2022, AK e ka publikuar njoftimin mbi vendimin.

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTIN

***N/A***

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

***N/A***

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESAVE

**Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit të prokurimit**

Autoriteti Kontraktues, me anë të ketij aktiviteti të prokurimit publik ka synuar të nënshkruajë një kontratë kornizë me një Operator Ekonomik, në kohëzgjatje prej 36 muajsh për ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe avansimit te sistemit të instaluar të menaxhimit të informatave në laborator (LIMS) ne AKF.

OE ankues në Ankesën me numër **P.SH. 124/22**, pretendon së gjatë udhëheqjes se këtij aktiviteti

të prokurimit publik AK ka vepruar në kundërshtim me këto nene të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës:

**Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;**
**Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 2 dhe**
**Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.**

Eksperti shqyrtues i prokurimit në pajtim me autorizimet e mundësuara për të nga ana e LPP-së, konkretisht nenin 114 te Ligjit 04/L-042 i plotësuar, ndryshuar, i ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore te OE ankues dhe të njejtave i'u është përgjigjur si në vijim.

**Përgjigje në pretendimet ankimore të ankesës 124/22:**

Eksperti shqyrtues i prokurimit lidhur me pretendimet ankimore te OE ankues për shkeljet e pretenduara nga AK të nenëve 59.2 dhe 72 të LPP-së, pas kontrollimit të rrjedhës së aktivitetit të prokurimit, faktet dhe të gjeturat gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë, konsideron se AK nuk ka berë shkelje të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, dhe pas kontrollimit të dosjes së dorëzuar nga OE ankues, krahasimit me LPP dhe RRUOPP ka konstatuar se nënshkrimi i dokumenteve të cekura, janë berë nga personi për të cilin OE nuk ka ofruar apo bashkagjitur autorizimin përkatës, e gjithashtu duke e marrë parasysh edhe interpretimin nga ana e KRPP-së, te paraqitur në foton më poshtë (interpretim tek i cili janë thirrur edhe AK-ja):

***40. Si të veprohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar?***

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent , nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.?

Mendoj qe në ketë rast OE ankues ka berë lëshim teknik për të cilin nuk mund të zbatohen nenet 59 dhe as ai 72 i LPP-së edhe nëse aktiviteti kthehët në rivlerësim, andaj propozoj që pretendimi ankimor i OE ankues të refuzohet **si i pabazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ASSECO SEE SH.P.K., lidhur me shkeljen e pretenduar te nenit 6 të LPP-së, nga ana e AK-së, eksperti shqyrtues i prokurimit, pas analizimit te Njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit, specifikacionit teknik dhe ofertës se detajuar të dorëzuar nga ana e OE ankues, thekson se për tu shpërblyer me kontratë, kushti bazik është që tenderi të jetë administrativisht dhe teknikisht i përgjegjshëm dhe po ashtu me çmimin me të ulët, oferta e OE ankues është oferta më çmimin me të ulët por fatkeqësisht për mendimin tim është e papërgjegjshme administrativisht, andaj konsideroj qe gjithashtu në këtë rast AK ka vepruar në pajtim me nenin 6 të LPP-së, pra nuk ka shkelje të tij.

Sa i përket arsyetimit të dytë të refuzimit të ofertës së OE ASSECO SEE SH.P.K., konkretisht, shiko në vijim pjesën e shkëputur nga njoftimi mbi vendimin e AK-së (foto):

2. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

a. Minimum dy (2) Ekspert për zhvillim të softuerit më përvojë mbi 3 vjeçare në zhvillim të softuerit
b. Minimum një (1) Ekspert të bazave të te dhënave më përvojë mbi 3 vjeçare në administrim dhe zhvillim të bazave të te dhënave,;

Dëshmia:
a. Ekspertet për zhvillim të softuerit të dëshmohet me •kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose certifikatat profesionale e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtare ose të autorizuara nga ta për zhvillim te softuerit, •për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar.
b. Eksperti të bazave të te dhënave të dëshmohet me
•kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose certifikatat profesionale e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtar ose të autorizuara nga ta për administrim dhe zhvillim te bazave te të dhënave.
•për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar.

Ju për ketë kërkesë keni prezantuar listën e punëtoreve dhe dëshmitë tjera kopjen e diplomave universitare për fushën e TI.
Mungon përvoja për stafin e kërkuar me dosje te tenderit , nuk keni dorëzuar reference nga punëdhënësi/it për përvojën 3 vjeçare te stafin e kërkuar.
**prandaj nga arsyet e cekura më lartë oferta juaj nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm**

Eksperti shqyrtues konsideron se OE ankues ka dorëzuar dokumentacion të stafit dhe ofertë teknike në përputhje me kërkesat përkatëse në FTD dhe specifikacion teknik dhe që arsyetimi për mos plotësim te të njejtave nga ana e komisionit vlerësues të AK-së për mendimin tim është i padrejtë, ngase OE ka ofruar deshmi të mjaftueshme për staf dhe kontrata të realizuara të natyrës së ngjajshme.

Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së që ankesën me nr. P.SH. 124/22 ta **aprovojë si pjesërisht të bazuar**.

**Pretendimet Ankimore te ankesës nr. P.SH. Nr. 129/22, nga OE PBC SH.P.K.**

OE ankues në ankesën e tij pretendon se gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteti te prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7 paragrafi 2; nenin 59 paragrafi 4 dhe RRUOPP-në.

**Përgjigje në pretendimet ankimore të ankesës 129/22:**
Eksperti shqyrtues i prokurimit lidhur me pretendimet ankimore te OE ankues, pas kontrollimit të rrjedhës së aktivitetit të prokurimit, njoftimin për kontratë, specifikacionin teknik dhe ofertën apo komplet dosjen e dorëzuar nga OE i propozuar për tu shpërblyer me kontratë, iu është përgjigjur pretendimeve ankimore te OE ankues PBC SH.P.K., si në vijim:

**Pretendimi Ankimor A pjesa e parë dhe pjesa e dytë: OE i propozuar për tu shpërblyer me kontratë nuk ka dorëzuar listen e kontratave në përputhje me NJK dhe DT.**

Eksperti shqyrtues i prokurimit pas kontrollit dhe analizës së njoftimit për kontrate dhe FTD dhe duke e krahasuar me dokumentet e ofruara nga OE i propozuar për tu shpërblyer me kontratë dhe lidhur me ketë pretendim i ka bashkangjitur:

Kërkesen obligative nga FTD ku kërkohet listë e kontratave ku specifikohën shërbimet e përfshira si në foton më poshtë:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | **Kapaciteti teknik dhe professional:**<br><br>**Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare* |
| | | **a.Minimum dy (2) Ekspert për zhvillim të softuerit më përvojë mbi 3 vjeçare në zhvillim të softuerit** | **a.Ekspertet për zhvillim të softuerit të dëshmohet me •kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose certifikatat profesionale e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtare ose të autorizuara nga ta për zhvillim te softuerit, •për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar.** |
| | | **b. Minimum një (1) Ekspert të bazave të te dhënave më përvojë mbi 3 vjeçare në administrim dhe zhvillim të bazave të te dhënave,;** | **b. Eksperti të bazave të te dhënave të dëshmohet me**<br><br>**•kopjen e diplomave universitare për fushën e TI ose certifikatat profesionale e lëshuar nga kompani certifikuese ndërkombëtar ose të autorizuara nga ta për administrim dhe zhvillim te bazave te të dhënave.**<br><br>**•për përvojën e punës-kontrata ose referencë nga punëdhënësit për përvojën e punës së kërkuar.** |
| | | **c. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku (1) një kontrat për shërbime në lëmin e zhvillimit të softuerëve ose mirëmbajtjes së sistemeve (softuerëve) të realizuar në tri vitet e shkuara para datës së publikimit te këtij njoftimit për kontratë.** | **c. Listën e kontratave që specifikon shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin, duke ia bashkëngjitur dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë, (kopje).** |

Dhe duke e krahasuar me dokumentin e dorëzuar nga ana e OE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë, si në foton në vijim:

LEAD tech

**LISTA E KONTRATAVE TË REALIZUARA**

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | E-maili i Blerësit | Nurmi i telefonit te Blerësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mirëmbajtja e sistemit IBIS me numër identifikues 214/18/008/125<br><br>Kontratë 36 muaj | 01.07.2018 | 01.07.2021 | **382,500.00 €** | Ministria e Punëve të Brendshme | Besim SHALA<br><br>Menaxher i Kontratës<br><br>besim.i.shala@rks-gov.net | 044- 201-765 |

*LEADTECH SH.P.K.*

SH.P.K. LEADTECH Prishtinë

Bregu i Diellit Rr.Major Mehemt Bushi Ll.19, Hy.14 Prishtine Tel: +383 (0) 44 261 361 Email: contact@leadtech.info

Nga e cila nuk mund të konstatohen shërbimet e kryera për ketë kontratë, por vetëm titulli i kontratës, informata këto, të cilat për mendimin tim nuk i plotësojnë kërkesat minimale obligative të specifikuara në Njoftimin për Kontratë dhe FTD.
Por specifika për shërbimet konkrete lidhur me ketë kontratë, të ofruara nga OE i propozuar për tu shpërblyer me kontratë nuk kam mundur të gjejë as në referencën dhe kontratën e bashkangjitur nga ana e këtij OE për të njejtin projekt.

Për këto arsye të cekura si më sipër eksperti shqyrtues i prokurimit mendon se AK nuk ka respektuar paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, duke shpallur fitues OE i cili nuk ka dorëzuar listën e kontratave sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit. Andaj propozoj që pretendimi ankimor i OE ankues për këtë pika të aprovohet **si i bazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

**Pretendimi Ankimor B: OE i propozuar për tu shpërblyer me kontratë nuk ka dorëzuar ofertë teknike sipas kërkesës ne NJK por ka nënshkruar dhe vulosur kërkesën e AK-së Aneks 1.**

Eksperti shqyrtues i prokurimit duke u bazuar në pretendimin ankimor B, analizën e fakteve të bashkangjitura në ankesë, dokumenteve të shkarkuara, rrjedhën dhe analizën e aktivitetit të prokurimit konstaton se AK nuk ka vepruar në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së dhe RUOPP-së duke shpallur fitues OE i cili nuk ka dorëzuar specifikimin e detajuar, rrjedhimisht nuk ka konfirmuar ose deklaruar se i njëjti do te përfundoj punët sipas kërkesës në NJK dhe FTD, kërkesë e cila është e cekur edhe në pjesën e dytë, pika 4 e Aneksit 1, Specifikimet e detyrueshme teknike, si ne foton më poshtë:

FUSHËVEPRIMI I MIRËMBAJTJES PËR SISTEMIN LIMS

2. Kontrata do të jetë për një periudhë **36 muaj**, nga data e nënshkrimit të marrëveshjes (kontratës) mbi baza gjithëpërfshirëse për mirëmbajtje nga distanca, ne linje dhe shërbime ne lokacion.
3. Është e domosdoshme që kontraktori të ketë shërbimin e servisimit në Kosovë dhe preferohet brenda qytetit të Prishtinës.
4. Kontraktori duhet të jetë gjithmonë në pozicion për të udhëzuar, ndihmuar në lidhje me serverin e sistemit LIMS, dhe që punët të kryhen pa asnjë vonesë. Kjo duhet të konfirmohet në mënyrë specifike në ofertë.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, nuk ka hasur në ndonjë dokument të dorëzuar nga OE i propozuar, i cili do të ishte në pajtim me kërkesen e AK-së, pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar specifikim të detajuar, deklaratë ose konfirmim se i plotëson kërkesat e AK-së., përpos që e ka nënshkruar dhe vulosur Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit.
Në RUOPP, përmes shembujve, tregohet qartë se si duhet të veproj AK në raste të tilla: *("specifikimi teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar) qarte se çfarë duhet te dorezohet".*

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sa i përket pjesës së dytë te pretendimit B të OE ankues, konstaton se AK nuk ka respektuar paragrafin 4 të nenit 59 të LPP dhe RUOPP, duke mos analizuar me në detaje dokumentet e pranuara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe gjithashtu

duke mos e shqyrtuar detajisht pretendimin e OE ankues ku qartë mund të vërehen angazhimet e stafit të caktuar për këtë projekt në ndërrmarje tjera dhe janë të bashkangjitura vetëm letër referencat e lëshuara për ta nga ana e OE të propozuar, por e tërë kjo mund të konstatohet lehtë tek anëtari i stafit i cili është i paraparë si "*ekspert dhe zhvillues i bazave te të dhënave*", i angazhuar tek ky OE nga viti 2018 (e cekur në referencë te OE fitues), e për qudi e ka të bashkangjitur edhe pasqyrën e trustit pensional, ne të cilen askund nuk figuron emri i OE të propozuar për shpërblim me kontratë si pagues i trustit pra rrjedhimisht i tatimeve obligative.
Por edhe te dy anëtaret tjerë te stafit, askund nuk dokumentohet që këta dy anëtar janë të angazhuar nga ky OE, përpos në letër referencat e OE të propozuar, kurse në CV e tyre, del se të dytë janë të angazhuar në kompani tjera.
Marrë parasysh këto deshmi të cekura, propozoj qe Paneli Shqyrtues i OSHP-së **të aprovoj si të bazuar** këtë pretendim ankimor të OE.

**Pretendimi Ankimor C:** Pretendimi ankimor lidhur me kohëzgjatjen e sigurimit të ofertës së dorëzuar nga ana e OE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë.
Eksperti shqyrtues i prokurimit duke u bazuar në analizën e fakteve të bashkangjitura në ankesë, dosjes së tenderit, raportit të vlerësimit dhe numrimit të ditëve (90 ditë) nga data e dorëzimit të ofertës, konstaton se OE i propozuar ka dorëzuar sigurim të ofertës në përputhje me kërkesën obligative, dhe për këtë pretendim ankimor, i propozoj Panelit Shqyrtues **te refuzohet si i pabazuar**.

**Përmbyllje e ekspertizës:**
Eksperti shqyrtues i prokurimit i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së, të sjellë vendim për aprovim **si pjesërisht të bazuar të këtyre dy ankesave**, por duke e marrë parasysh konstatimet e ekspertit shqyrtues të prokurimit sa i përket ankesës me numër P.SH. 124/22, oferta e OE ankues duhet të konsiderohet si administrativisht e papërgjegjshme. Kurse ankesa me numër P.SH. 129/22 **të aprovohet si pjesërisht e bazuar** dhe rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i OSHP-së të sjellë vendim **për anulimin e njoftimit** për shpërblim me kontratë dhe aktivitetin e prokurimit ta sjellë në rivlerësim, ashtu që rivlerësimin ta bejë në përputhje të plotë me LPP-në dhe RRUOPP-në.

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Duke u bazuar në të gjeturat, krahasimet, faktet, dokumentet e shqyrtuara dhe të cekura, eksperti shqyrtues i prokurimit propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE-ve të aprovohen si **pjesërisht të bazuara** dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së të sjellë vendim dhe ta obligojë AK-në që ta anuloj njoftimin mbi vendimin për shpërblim me kontratë dhe të kthej e aktivitetin në **rivlerësim** dhe rivlerësimin ta bejë në përputhje të plotë me LPP-në dhe RRUOPP-në

**Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:**

- Autoritetit Kontraktues - "Ministria e Punëve të Brëndshme"
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - OE "ASSECO SEE Sh.P.K." dhe OE "PBC SH.P.K.".